



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
FIER**

N J O F T I M

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURËS SË KONKURIMIT PËR EMERIMIN NË
POZICIONIN E PUNËS NJË VEND "SEKRETAR/E PRANË PROKUROREVE**

"Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier , kërkon të punësojë në pozicionin **1 (një) punonjës në administratë me detyrë "Sekretar/e pranë prokurorëve"**.

Bazuar në nr. 97/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë",

N J O F T O N:

Fillimin e procedurës së hapur për konkurim të hapur të kandidatëve për pozicionin **I (një) vend "Sekretar/e pranë Prokurorëve"** në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier .

Kandidatët e interesuar për konkurim duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje si dhe të mos jetë apo mos të ketë qënë nën hetim;
- Ndaj tij te mos jetë marrë masa disiplinore në mardhënie punëdhe/ose shërbim civil që nuk është shuar sipas ligjit
- Të ketë përfunduar ciklin e parë të studimit Bachelor në drejtësi dhe ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi.
- Të kenë përvojë prej të paktën një viti të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë.

2. Kushtet e posaçme:

- Të ketë aftësi për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
- Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup.
- Të ruajë sekretin hetimor.
- Të ketë integritet dhe cilësi të larta morale si dhe sjellje etike.
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike të tilla si Microsoft: Word, excel, power point, etj.
- Të ketë njohuri të gjuhëve të huaja.

3. Kriteria të preferuara :

- Të ketë njohje të sistemit të drejtësisë penale dhe procedurave gjyqësore.
- Të ketë kualifikime, njohje ose eksperiencë në fushën e zbatimit dhe/ose praktikimit të legjislacionit përkatës në fushën e të drejtës administrative, të ligjeve organike të drejtësisë si dhe në fushën e arkivave (eksperienca si rregull mbi I vit).

Personat e interesuar duhet të paraqesin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier këto dokumenta:

- a) Kërkesë për punësim.
- b) Fotokopje e letërnjoftimit/kartës së identitetit/pasaportë.
- c) CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.
- d) Diplomë e shkollës së lartë, master, çertifikatë notash dhe çdo diplomë tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.
- e) Dëshmi penaliteti.
- f) Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.
- g) Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.
- h) Vërtetim mbi masat disiplinore në fuqi.
- i) Vërtetim vendbanimi.
- j) Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore.
- k) Referenca të mundshme nga punëdhënësi të mëparshëm.

Pranimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët do të bëhet në Kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier , deri në datën 10.10.2022 ora 16.00 duke konfirmuar marrjen në dorëzim sipas inventarit të akteve të dorëzuara.

Konkurimi zhvillohet në dy faza :

Faza e parë :Verifikimi paraprak i kandidatëve do të bëhet nga K/sekretaria e kësaj Prokurorie, e Cila pasi të marrë praktikën dokumentare për secilin kandidat duhet të verifikojë nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe veçanta. Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dyte : Kandidatët e kualifikuar i nënshtrohen vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë nga Komisioni i Pranimit.

Drejtuesi i Prokurorisë është organi në të cilin aplikuesit mund të paraqesin ankimmimet/kundërshtimet e mundshme mbi cdo vendim të marrë në cdo fazë të konkurimit.

Testimit me shkrim dhe me gojë me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier

Data dhe ora e zhvillimit të testimit do të njoftohen nga K/sekretaria e institucionit në adresat respektive të kandidatëve.

Ky testim do të përmbajë pyetje nga:

- ✓ Kodi Penal RSH.
- ✓ Kodi Procedurës Penale RSH.
- ✓ Kodi Procedurave Administrative RSH.
- ✓ Ligji nr.97/2016.

Pikëzimi i renditjes së aplikantëve është si vijon :

- ✓ Dokumentacioni 20 pikë.
- ✓ Testimi 40 pikë
- ✓ Intervista 40 pikë.

Konsiderohen të kualifikuar kandidatët që në përfundim të procesit kanë marrë më shumë se 70 pikë.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 0342223, ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al.

KOMISIONI I PRANIMIT PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT NË

PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR FIER